

VENDIM
Nr. 519, datë 13.7.2016

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 97, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OSHEE sh.a., OST sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

MODELI SHQIPTAR I TREGUT

Hyrje

Zhvillimi dhe miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut (MSHT) është hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë në një treg plotësisht konkurrues të energjisë, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky miratim është pjesë e reformës që qeveria e Shqipërisë kandërmarrë për rindërtimin e sektorit të energjisëelektrike, në përputhje me ligjin e ri nr. 43/2014, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe politikate qeverisë për zhvillimin e këtij sektori.

Së pari, Modeli Shqiptar i Tregut (MSHT) është hartuar në bazë të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2006. Nëpërputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është angazhuar për zbatimin e paketës së tretë të energjisë, që është miratuar nga Këshilli i Ministrave të këtij Traktati në vitin 2011.

Së dyti, Shqipëria është angazhuar në Samitin e Vjenës, më 27 gusht 2015, të zbatojë një sërë masash afatshkurtra, në kuadër të procesit të Berlinit (Ballkani Perëndimor 6). Modeli i tregut synon mbështetjen për zbatimin e angazhimeve të marra në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe akteve nënligjore përkatëse.

Së treti, si një proces i lidhur ngushtë me dy zhvillimet e përmendura më sipër, është iniciuar një proces

¹ Me ngjyrë të kuqe janë reflektuar ndryshimet dhe shtesat sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 27.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.519, datë 13.07.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”

drejt krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE), i cili kërkon, gjithashtu, përafrimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike, në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë.

Ky model pritet të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të krijojë kushtet për integrimin e mëtejshëm rajonal, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinje.

Modeli Shqiptar i Tregut merr në konsideratë:

- harmonizimin e legjislacionit të sektorit të energjisë dhe mënyrës së funksionimit të tregut me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- finalizimin e procesit të kalimit nga struktura vertikalisht e integruar e sektorit të energjisë elektrike drejt një strukture ligjërish, funksionalisht dhe financiarisht të ndarë në furnizim, prodhim, transmetimit dhe shpërndarje, me qëllim që të mundësojë konkurrencën në tregjet me shumicë dhe pakicë;
- zhvillimin e tregut të energjisë elektrike sipas rregullave të qarta të tregut dhe kodeve të rrjetit, si kushte minimale teknike për një funksionim efikas të sistemit elektroenergjetik;
- përfitime më të larta për konsumatorët në drejtim të sigurimit të furnizimit me energji elektrike dhe drejt një shërbimi cilësor;
- shfrytëzimin më efikas të tregtimit ndërkufitar, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinje, duke lejuar përfitimin e sektorit shqiptar të energjisë elektrike në drejtim të përdorimit me eficiencë të burimeve tona gjeneruese;
- zbatimin e aksesit të palëve të treta për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jodiskriminues;
- liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin e numrin e pjesëmarrësve, krijon kushtet për hapjen e sektorit drejt konkurrencës dhe rrit pjesëmarrjen e investitorëve të huaj;
- monitorimin dhe rregullimin e tregut të energjisë elektrike nga ERE, si një institucion i pavarur;
- nevojën për të hartuar dhe zbatuar rregulla për kryerjen e transaksioneve në tregje transparente dhe jodiskriminuese, për të shmangur manipulimin dhe abuzimin e tregut, si dhe kryerjen e tregtimit të brendshëm, në përputhje me praktikatat më të mira evropiane;
- integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike me tregun rajonal të Evropës Jug-lindore, dhe, më vonë, me tregun evropian të energjisë elektrike, i cili do të jetë një udhëzues i parimeve të funksionimit të këtij tregu.

Në këtë Model, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Operatori i tregut - Bursa Shqiptare e Energjisë (BSHE)” - është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregtimit, platformës elektronike të klerimit dhe të shlyerjeve financiare për tregjet e ankandeve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe tregjeve të vazhdueshme brenda së njëjtës ditë, ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike;

“Treg energjie elektrike” - një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra;

“**SEE CAO**” – Zyra e Koordinuar e Ankandëve në Evropën Juglindore, e krijuar në Podgoricë, Mali i Zi, dhe që ka kompetencë kryerjen e ankandëve të kapaciteteve të transmetimit të OST-ve pjesëmarrëse në këtë zyrë;

“**Kontratë për diferencë**” (CfD) - një marrëveshje tip, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërmjet operatorit të energjisë së rinovueshme dhe prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme, i cili është deklaruar ofertuesi i suksesshëm në ankandin për të marrë ndihmë operacionale dhe në investime;

“**Palë Përgjegjëse Balancuese**” - të gjitha subjektet juridike që, në përputhje me këtë model dhe legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për parashikimin e tyre të prodhimit dhe konsumit;

“**Palë Shërbyese për Balancimin**” - çdo subjekt juridik që, në përputhje me këtë model dhe legjislacionin në fuqi, ofron shërbime balancimi për OST-në;

“**Kontrata financiare OTC**” - transaksione financiare të shitblerjes së energjisë elektrike, jo të kryera nëpërmjet bursës së energjisë elektrike.

Çdo term tjetër, i përdorur në këtë model, ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Ky model nuk do të interpretohet si kufizues apo ndalues me çfarëdo iniciativë në sektorin e energjisë elektrike dhe/ose angazhimeve që Shqipëria mund të ndërmarrë në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

1. Qëllimet dhe objektivat e modelit të tregut

1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i modelit të tregut:

- Të krijojë kushtet për një treg konkurrues të energjisë elektrike, i cili lejon vendosjen e çmimeve të drejta që burojnë nga zbatimi i një tregu të qëndrueshëm, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

- Të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit dhe eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike panevropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (*day ahead market*) dhe tregut brenda ditës (*intraday market*);

- Të krijojë kushtet për kalimin transparent dhe efikas të flukseve të fondeve dhe llogarive, duke përdorur BSHE-në si një organizëm qendror për të gjithë tregtarët në tregun e organizuar.

1.2 Kërkesat për funksionimin e modelit të tregut në mënyrë eficiente:

- hartimi i rregullave transparente dhe të përshtatshme për BSHE-në, pjesëmarrësit e tregut, përfshirë operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

- mbikëqyrja rregullatore nga ERE, me masa shtesë, për të garantuar transparencën, akses të barabartë dhe jodiskriminues në treg dhe në rrjet;

- proceset e monitorimit të tregut dhe të raportimit të të dhënave;

- rregullat e tregut dhe kodet e lidhura me to, që garantojnë një mbrojtje efektive kundër abuzimeve në treg dhe praktikave të padrejta tregtare.

1.3 Qëllimet të tjera të rëndësishme të modelit të tregut:

- të marrë në konsideratë transformimin e subjekteve të integruar vertikalisht, në entitete

funksionalisht, ligjërishit dhe financiarisht të ndara në bazë të kërkesave të paketës së tretë rregullatore;

- të krijojë një strukturë, brenda së cilës të zhvillohet konkurrenca, si në tregun me shumicë ashtu edhe në atë me pakicë, për të mundësuar dhe promovuar ndryshimin e shpejtë të furnizuesit.

2. Objektivat

Modeli Shqiptar i Tregut karakterizohet si një treg me shumicë, i bazuar në transaksione dypalëshe dhe kontrata të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (*Over the Counter - OTC*) ose si një treg i organizuar i ditësnë avancë dhe tregut brenda ditës, i organizuar nëpërmjet bursës BSHE. ERE është përgjegjës për të miratuar, në bashkëpunim me Sekretariatine Komunitetit të Energjisë dhe në konsultim me Autoritetin e Konkurrencës, Komisionin e Ndihmës Shtetërore dhe pjesëmarrësit e tregut, masat e duhura për të siguruar përmbushjen e kriterëve të transparencës dhe të hapjes së tregut dhe masat në lidhje me sigurinë e furnizimit.

Çdo formë e tarifave apo e çmimeve të rregulluara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, si dhe çdo formë subvencionit për kategori të ndryshme të konsumatorëve, do të eliminohet, me përjashtim të tarifave të rregulluara, që janë të mbuluara nga detyrimi i shërbimit publik, në përputhje me detyrimet e ligjit për sektorin e energjisë dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Modeli Shqiptar i Tregut synon përmbushjen e objektivave të qeverisë së Shqipërisë në drejtimtë:

i) liberalizimit të plotë të tregut të energjisë elektrike dhe krijimit të një tregu/tregjeve të organizuar, pra një treg/tregje konkurrues/e të energjisë për tregtimin e flukseve fizike të ditësnë avancë apo brenda ditës;

ii) sigurimit të përputhshmërisë së Modelit Shqiptar të Tregut me dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

iii) funksionimit të tregut të energjisë si treg i energjisë balancuese, mbështetur në përgjegjësinë e palëve për disbalancat, rakordimin qendror të disbalancave dhe lehtësimin e integritit me tregjet e tjera balancuese;

iv) sigurimit të likuiditetit të nevojshëm, duke nxitur masa për një funksionim efikas të tregut/tregjeve të flukseve fizike të energjisë;

v) rritjes së efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit, duke qartësuar përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe duke siguruar informacion të mjaftueshëm në lidhje me operimin e tregut dhe krijimin e një strukture të qartë për transaksionet e tregut të energjisë elektrike.

Parimet kryesore të modelit të tregut, janë:

- **zbatimi i mbikëqyrjes dhe monitorimit të tregut, me qëllim shmangien e abuzimit në treg;**
- funksionimi si një treg i organizuar i ditësnë avancë dhe tregut brenda ditës, për tregtimin e flukseve fizike të energjisë elektrike, në periudhën kohore të ditës në avancë;
- tregtimi i kontratave fizike afatgjata dypalëshe do të lejohet në përputhje me kapacitetin e blerë dhe të nominuar në ankandet eksplicite të organizuara nga SEE CAO;
- **të gjitha format e tjera të tregtimit mund të jenë financiare ose fizike;**
- marrëdhëniet kontraktuale janë skemat bazë që shërbejnë për menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të ndryshme në treg.

Objekтиви përfundimtar i modelit të tregut është të integrojë tregun energjetik shqiptar në bashkimin e tregut panevropian. Deri në përmbushjen e këtij objekтиви, si një zgjidhje e

përkohshme,²:

- përdorimi i zonave të import/eksportit nënkupton caktimin e ditës në avancë në kapacitetin e import/eksportit nëpërmjet tregut, ku OST-ja vë në dispozicion, si pjesë e shpërndarjes së kapacitetit të tyre të përditshëm, një sasi minimumi (50%) të kapacitetit në dispozicion të tregut e organizuar. Sasia e vlerës minimale duhet të rishikohet në baza mujore. Vlera minimale mund të ndryshohet në bazë të një vlerësimi të përcaktuar nga ana e OST-së, miratuar nga ERE;
- detyrimet për pjesëmarrjen në të, të KESH- it dhe OSHEE-së, ku vëllimet e reduktuara nga kontrata aktuale e furnizimit KESH-OSHEE, bëhen të detyrueshme për t'u tregtuar në tregun e organizuar. Bazuar në një vlerësim nga ERE, një pjesë ose i gjithë volumi i kësaj kontrate do të mund të zbatohet si një kontratë për diferencë (CFD);
- qeveria e Shqipërisë do të ofrojë skemat mbështetëse, në përputhje me acquis përkatëse të Komunitetit të Energjisë, në formën e kontratave për diferencë (CFDs) për prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike dhe furnizuesit e energjisë së rinovueshme, për të zëvendësuar marrëveshjet e tyre aktuale për blerje të energjisë, duke i lejuar ata të bëhen Palë Përgjegjëse Balancuese (PPB), sipas modelit të tregut. Çdo ndryshim në skemën mbështetëse do të përcaktohet në ligjin për burimet e rinovueshme.

Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në operimin fizik të modelit të tregut përcaktohen me marrëveshje ndërmjet pjesëmarrësve individualë dhe BSHE-së e OST-së, ose rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve standarde të zbatueshme dypalëshe.

3. Rolet e modelit të tregut

3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)

OST-ja është kompania e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:

- funksionin e operimit fizik të rrjetit të transmetimit (pronësinë, mirëmbajtjen dhe zgjerimin);
- funksionin e Operatorit të Sistemit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 dhe direktivës 2009/72/CE, duke përfshirë dispeçerimin;
- sigurimi i shërbimit të lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetet e transmetimit, në kushte jodiskriminuese;
- përcakton kushtet për t'u bërë Palë Përgjegjëse Balancuese (PPB) dhe Palë Shërbyese për Balancimin (PSB);
- zbaton procesin e llogaritjes së kapaciteteve ndërkufitare të interkonjeksionit, të koordinuara në përputhje me kërkesat në tregjet e organizuara.

OST-ja kryen funksionin e Operatorit të Tregut Balancues, nëpërmjet:

- parashikimit dhe blerjes së shërbimeve ndihmëse, të ndara në energji balancuese dhe

² b) Paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përmbushjen e këtij objekti kërkohet:

- OST-ja të vendosë në dispozicion të tregut të organizuar një sasi minimum (50%) të kapaciteteve ndërkufitare të disponueshme, që i përket bashkimit respektiv të tregjeve. Sasia e vlerës minimale duhet të rishikohet në vijueshmëri dhe mund të ndryshohet në bazë të një vlerësimi të propozuar nga ana e OST-së dhe të miratuar nga ERE. BSHE-ja ka të drejtë t'i kërkojë OST-së iniciimin e procesit të mësipërm të rishikimit të sasisë minimale.”.

kapacitet rezervë, nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Balancuar (OSB-ve), në një javë, ditën përpara dhe afatin kohor real të bazuar në treg;

- kryerjes së veprimeve të nevojshme për balancimin, duke aktivizuar rregullimin sekondar në ulje (*downward*) ose rritje (*upward*) nga rezervat balancuese dhe/ose të rezervave shtesë balancuese, të ofruara në tregun e balancimit të energjisë elektrike;
- blerjes së humbjeve në transmetim, në tregun e organizuar të ditës në avancë. Për një periudhë ndërmjetëse, ku produktet që tregtohen në një treg të organizuar nuk lejojnë blerjen me kosto optimale të humbjeve, procedurat e prokurimit janë të lejuara për OST-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE;
- kompensimit të tij për shërbimet e balancimit, duke siguruar likuidimin financiar mbi baza mujore, nëpërmjet shlyerjes së disbalancave, të mbështetura në rregullat e llogaritjes së disbalancave, duke siguruar nxitjet e duhura për pjesëmarrësit e tregut, që të jenë të balancuar në kohë reale dhe të afërt me kohën reale. Rregullat e llogaritjes së disbalancave pasqyrojnë devijimet ndërmjet gjenerimit të energjisë, energjisë së tregtuar dhe konsumit të palëve përgjegjëse balancuese dhe të ekuilibrit të çdo Pale Përgjegjëse Balancuese. Ajo është e bazuar në një sistem të vetëm të çmimeve, duke penalizuar devijimet në të dyja drejtimet;
- menaxhimit të mbledhjes së kërkuar të të dhënave të matjes, për të kryer një menaxhim efikas të disbalancave dhe shlyerjes financiare të tyre;
- çmimi i energjisë së disbalancave që do të paguhet nga PPB-të do të vendoset në bazë të koston reale për OST-në, për të balancuar sistemin për periudhën përkatëse, që mbulon rezervat balancuese dhe të energjisë.

Tarifat, termat dhe kushtet e aksesit në sistemin e transmetimit do të rregullohen nga ERE.

3.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

OSSH-ja do të zotërojë, mbajë, zgjerojë dhe operojë sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe do të ndahet nga furnizimi, në përputhje me rregullat e Komunitetit të Energjisë.

OSSH-ja do të ofrojë shërbimin e lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në kushte jodiskriminuese.

OSSH-ja do kryejë blerjen e humbjeve teknike dhe joteknike në tregun e organizuar të ditës në avancë (BSHE). Për një periudhë ndërmjetëse, ku produktet që tregtohen në një treg të organizuar nuk lejojnë blerjen me kosto optimale të humbjeve, procedurat e prokurimit janë të lejuara për OSSH-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE.

Tarifat, afatet dhe kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes do të rregullohen nga ERE.

OSSH-ja do të jetë përgjegjëse për reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike në sistemin e shpërndarjes, në bazë të një studimi të përgatitur nga konsulentë ndërkombëtarë, të kontraktuar nga OSSH-ja dhe të miratuar nga ERE. ERE do të vendosë një tarifë për OSSH-në, që siguron incentiva për reduktimin e këtyre humbjeve.

OSSH-ja do të jetë një PPB.

3.3 Pala Përgjegjëse Balancuese (PPB)

Termtat dhe kushtet për t'u bërë një PPB përcaktohen nga OST-ja dhe rregullohen nëpërmjet një

marrëveshjeje ndërmjet PPB-së dhe OST-së.

Të gjitha subjektet juridike, që zotërojnë njësi të prodhimit dhe konsumit, të lidhura në rrjet dhe mbi një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe të miratuar ERE, janë të detyruara për të qenë një PPB.

Çdo subjekt juridik, që zotëron njësi të gjenerimit dhe konsumit, të lidhura me rrjetin dhe nën një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe të miratuar nga ERE, mund të aplikojnë për t'u bërë një PPB. Çdo tregtar, që tregton në Shqipëri apo që furnizon energjinë ndërkufitare, është PPB.

PPB-ja lejohet të skedulojë kontratat dypalëshe fizike për të blerë/shitur kapacitet e shpërndara në SEE CAO.

Tregtimet e brendshme afatgjata OTC mund të bazohen në një kontratë financiare ose fizike. Në rast kur OTC-ja bazohet në një kontratë financiare, energjia elektrike fizike do të tregtohet nga BSHE-ja dhe çmimi i BSHE-së do të jetë çmimi i referencës për kontratën financiare. ERE do të miratojë kontratën tip financiare OTC.

Një PPB mund të marrë përgjegjësitë e PPB-ve të tjera ose të njësisve të prodhimit dhe konsumit nën një kapacitet të miratuar.

Të gjitha PPB-të janë përgjegjëse për parashikimin e tyre të prodhimit dhe konsumit.

Të gjitha PPB-të janë të detyruara të mbrojnë informacionin konkurrues dhe konfidencial, kur është e nevojshme, si dhe çdo informacion të kërkuar nga ERE dhe OST-ja, sipas legjislacionit në fuqi.

Çdo palë që do të ushtrojë aktivitetin e furnizuesit është e detyruar të jetë PPB.

BSHE do të trajtohet si PPB me të drejta të veçanta, sipas parashikimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit (RrTSHB). OST-ja ngarkohet të reflektojë këto parashikime në RrTSHB.

3.4 Ofruesi i Shërbimeve të Balancimi (OSB)

OSB-ja është një PPB që ofron shërbime balancimi për OST-në.

Kushtet dhe kriteret për t'u bërë OSB përcaktohen nga OST-ja dhe rregullohen në një marrëveshje ndërmjet OSB-së dhe OST-së.

3.5 BSHE kryen funksionet:

a) e Operatorit të Tregut në Shqipëri, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të këtij vendimi dhe rregullave të tregut, me licencimin nga ERE-ja;

b) e sigurimit të platformës elektronike të nevojshme për tregtimin e energjisë elektrike në tregun e ditës në avancë dhe tregjet brenda së njëjtës ditë;

c) e sigurimit të platformës elektronike të klerimit dhe shlyerjes financiare të transaksioneve në tregjet e BSHE-së;

ç) e kundërpalës qendrore në garantimin e transaksioneve të palëve të tjera pjesëmarrëse në Bursë, nëpërmjet kërkesave të saj, rregullave përkatëse të tregut për nevojën e garancive, llojeve të tyre, të cilat do të ekzekutohen nga BSHE-ja, në rast të mospërbushjes së detyrimeve;

d) e monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregut të organizuar, në përputhje me kërkesat e rregullores për integritet, transparencë (REMIT);

dh) e hartuesit të rregullave për tregtimin në Bursë, për t'u paraqitur për aprovim tek ERE-ja.

Në kuadër të përmbushjes së këtyre funksioneve, BSHE-ja kryen këto detyra:

- a) siguron të gjitha platformat e mësipërme për operimin e tregjeve të BSHE-së;
 - b) pranon kërkesa dhe oferta për të blerë dhe shitur energji nga anëtarët e Bursës;
 - c) merr dhe proceson kapacitetet e interkonjeksionit nga OST-ja, si dhe informacione të tjera përkatëse;
 - ç) kryen ankandet e nevojshme dhe operacionet tregtare, në përputhje me rregullat e miratuara, duke përdorur për këtë qëllim, algoritmet e *Evropean Market Coupling*;
 - d) i dërgon anëtarëve përkatës të Bursës/anëtarëve të klerimit dhe OST-së, sipas afateve të përcaktuara, konfirmimet tregtare, duke përfshirë sasi të alokuara dhe çmimet;
 - dh) publikon sasi të shpërndara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara;
 - e) i dërgon anëtarëve përkatës të Bursës/anëtarëve të klerimit, në përputhje me afatin e rënë dakord, njoftimet e rezultateve;
 - ë) ekzekuton garancitë për shlyerjen e detyrimeve për anëtarët përkatës të Bursës/klarimit, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara;
 - f) mban dokumentet e transaksioneve;
 - g) mban dhe përditëson kalendarin e tregtimeve dhe të klerimeve;
 - gj) respekton kërkesat për transparencë dhe ushtron kompetenca të monitorimit të tregut;
 - h) garanton që platformat e BSHE-së janë të aksesueshme nga personat e certifikuar nga BSHE-ja;
 - i) të vlerësojë kërkesat për anëtarësim në BSHE, në përputhje me kërkesat e anëtarësimit;
 - j) të lidhë marrëveshje me aplikantët për pranimin e tyre në BSHE, në përputhje me kërkesat e anëtarësimit;
 - k) të konsultojë në vazhdimësi me palët e interesuar rregullat e BSHE, për çdo ndryshim të nevojshëm;
 - l) të procesojë urdhërporositë nga anëtarët e Bursës, duke i dërguar ato tek Operatori i Bashkimit të Tregjeve, për procesimin e nxjerrjes së rezultateve, duke përdorur algoritmet evropiane;
 - ll) të publikojë volumet e energjisë elektrike të alokuara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara;
 - m) të regjistrojë të gjitha transaksionet mbi tregjet e BSHE-së, të cilat do të jenë automatikisht të detyrueshme për t'u shlyer;
 - n) të marrë vendimet e nevojshme për integritetin dhe operimin e rregullt, duke përfshirë:
 - i. monitorimin e përputhshmërisë së anëtarëve të Bursës me rregullat dhe procedurat e BSHE-së;
 - ii. kryerjen e auditimeve dhe inspektimeve për aktivitetet e anëtarëve të Bursës.
- Bursa Shqiptare e Energjisë kontraktin kryerjen e një apo më shumë shërbimeve të sipërcituara nga çdo subjekt që mund të ushtrojë këtë aktivitet, në përputhje me licencën e lëshuar nga ERE-ja.

Bursa Shqiptare e Energjisë zbaton planin e masave për implementimin e Tregut Shqiptar të

Energjisë Elektrike, të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Roli i rregullatorit të pavarur (ERE)

ERE ushtron kompetencat e saj në zbatim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe direktivën 2009/72/CE.

Në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE do të reflektojë ndryshimet në Rregullat e Tregut dhe legjislacionin sekondar të nevojshëm për funksionimin e tregut. Në hartimin e këtyre rregullave, ERE do bashkëpunojë ngushtësisht me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

ERE, gjithashtu, do të miratojë rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara, të cilat hartohen nga OST-ja. ERE do të përcaktojë në Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut rregullat për implementimin e kufizimeve të ngarkesës ndërmjet konsumatorëve, kur ka një kufizim kapaciteti. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit, në mënyrë që këto rregulla të jenë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Në hartimin e këtyre rregullave, duhet të kërkohet mendimi i secilës palë të interesuar si dhe i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

ERE do të miratojë marrëveshje apo kontrata tip për një sërë marrëdhëniesh ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, të cilat përfshijnë:

- marrëveshje shërbimi të dyanshme, për shërbimet e shpërndarjes, ndërmjet OSSH-së dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes;
- marrëveshje për shërbimet e transmetimit, ndërmjet OST-së dhe PPB-ve;
- modele të kontratave financiare OTC, ndërmjet PPB-ve;
- kontrata tip, ndërmjet Bursës së Energjisë dhe PPB-ve, në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira evropiane.

ERE do të jetë përgjegjëse për përputhshmërinë e modeleve të kontratave me kuadrin ligjor fiskal. Zbatimi i kontratave dhe i detyrimeve tarifore nga gjithë pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë pagesën e plotë për energjinë dhe shërbimet e tjera, është thelbësore për suksesin e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

ERE, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, OST-në, Bursën e Energjisë, OSSH-në dhe pjesëtarët e tjerë të tregut, do të hartojnë skema të ekzekutimit të pagesave, që adresojnë çështjet e mospagesave apo pagesave të pjesshme. Për më tepër, ERE do të hartojë rregulla dhe procedura për ushtrimin e autoritetit e saj rregullator mbi PPB-të, në përputhje me marrëveshjet dhe do të ketë, gjithashtu, mundësinë e monitorimit të fluksit të parave. ERE do përdorë të gjitha instrumentet shtrënguese për zbatimin e pagesave dhe detyrimeve tarifore.

5. Pjesëmarrja në tregun e organizuar nuk do të jetë e kushtëzuar nga lëshimi i ndonjë licence specifike nga ana ERE-s. Licencat për OST-në dhe OSSH-në do lëshohen në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe legjislacionin sekondar. ERE do të përcaktojë kriteret dhe procedurën për licencimin e Bursës së Energjisë Elektrike.

5. Marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike

Qeveria shqiptare inkurajon investimet private në burime gjeneruese, për të përmbushur kërkesat e Shqipërisë për energji elektrike, për garantimin e sigurisë së furnizimit, nëpërmjet diversifikimit

të burimeve gjeneruese.

Në përputhje me ligjin e sektorit të energjisë elektrike dhe ligjin e konkurrencës, ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, do të përdorin autoritetin e tyre për të kufizuar afatin e kontratave afatgjata ndërmjet pjesëtarëve të tregut, në mënyrë që të shmangen efektet bllokuese në zhvillimin e tregut.

6. Procesi i likuidimit financiar

Procedurat e likuidimit financiar do të përfshihen në marrëveshjet tip përkatëse.

Procedurat e likuidimit financiar do të hartohen në mënyrë që të garantojnë transparencën dhe shlyerjen e TVSH-së gjatë procesit të pagesës, duke u siguruar që detyrimet e TVSH-së të mos pengojnë pjesëmarrjen në treg.

ERE do sigurojë që aktivitetet e palëve do kryhen në përputhje me këto rregulla dhe që të gjitha transaksionet financiare të jenë plotësisht transparente dhe të auditueshme.

Modeli i tregut synon të minimizojë riskun e manipulimit të tregut, duke u siguruar, kështu, tregtarëve garanci për funksionimin e tregut. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet pjesëmarrësve të tregut duhet të jenë të mirëpërcaktuara.

Periudha e pagesave të disbalancave duhet të harmonizohet me periudhat e produkteve të tregut, duke lejuar, kështu, PPB-të të balancojnë portofolet e tyre.

7. Marrëveshjet tip

Të gjitha marrëveshjet tip, që hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë model tregu:

- do t'u nënshtrohen një faze konsultimi me publikun, për të paktën katër javë, duke përfshirë publikimin në *website* dhe një njoftim për afatin e konsultimit, nga subjekti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve tip përkatëse. Rezultatet e konsultimeve publike do të publikohen;

- do t'u nënshtrohen një procesi të rregullt rishikimi, i cili mund të iniciohet me propozim të çdo pjesëmarrësi tregu;

- do të jenë hartuar apo rishikuar sipas një procedure të miratuar nga çdo subjekt përgjegjës për hartimin dhe rishikimin e marrëveshjeve tip. Kjo procedurë do të publikohet;

- do të synojnë të përafrojnë kërkesat e pjesëmarrësve të tregut me kërkesat në Komunitetin e Energjisë, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira evropiane në hartimin dhe kontrollin e marrëveshjeve tip;

- do të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. I gjithë dokumentacioni mbi hartimin, kontrollin, konsultimin dhe miratimin e marrëveshjeve tip duhet, gjithashtu, të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze;

- do të dërgohen për konfirmim në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë para miratimit.

8. Zbatimi i modelit të tregut

Modeli i tregut të organizuar, siç është përcaktuar në këtë tekst, do të jetë i aplikueshëm në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë.

ANEKSI 1

PLANI I MASAVE PËR IMPLEMENTIMIN E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Faza e parë - duke filluar nga 1 janari 2023

Tregu i rregulluar			
Blerjet (MWh)		Shitjet (MWh)	
Tarifat e rregulluara në nivelet 20, 10, 6 *dhe 0,4 kV	5,213,143	5,213,143	KESH
Humbjet e OSSH	1,366,592	1,366,592	
Total	6,579,735	6,579,735	Total
Tregu i parregulluar			
Blerjet (MWh)		Shitjet (MWh)	
Konsumatorët në 35 kV	80,120		
Total	80,120	80,120	Total

Faza e dytë - duke filluar nga janari 2024

Tregu i rregulluar			
Blerjet (MWh)		Shitjet (MWh)	
Tarifat e rregulluara në nivelin 0,4 kV	4,887,058	6,238,045	KESH
Humbjet e OSSH	1,350,987		
Total	6,238,045	6,238,045	Total
Tregu i parregulluar			
Blerjet (MWh)		Shitjet (MWh)	
	N/A	N/A	
Blerjet në voltazhin e lartë		435,482	
Konsumatorët në 35 kV	80,563		
Konsumatorët në 20 kV	245,086		
Konsumatorët në 10/6 kV	109,833		
Total	435,482	435,482	Total

*Duke filluar nga janari 2022 të gjithë konsumatorët e lidhur në 20/10/6 kV janë në treg të liberalizuar dhe mund të zgjedhin lirishit furnizuesin e tyre.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ata do të vijnë të furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit për një periudhë 2-vjeçare, deri në 31 dhjetor 2023.

ANEKSI 2

PLANI I VEPRIMIT PËR KRIJIMIN E BSHE-së (Shfuqizuar)